

*Ema Pula, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë.*

# Riorganizimi i Qeverisë

## Hyrje

Kanë kaluar katër vite që nga procesi i riorganizimit të Qeverisë që në vetvete kryesisht ka përfshirë reduktimin e numrit të ministrive por jo edhe organet tjera që janë në përgjegjësinë e tyre. Ky proces erdhi si rezultat i një premtimi elektoral dhe marrëveshjes të atëhershme në mes dy partive VV dhe LDK të cilat kishin bërë koalicion pas zgjedhor për formimin e Qeverisë të quajtur si Qeveria Kurti 1 në shkurt të vitit 2020. Nga 21 ministri,u propozua që të reduktohen në 15 si rezultat i marrëveshjes politike në mes VV dhe LDK[1]. Për shkak të ndryshimeve politike me formimin e Qeverisë Hoti gjatë po të njëjtit vit shtohet një ministri dhe nga 15 bëhen 16 ministri. Në vitin 2021 me formimin e Qeverisë Kurti 2, bëhen 15 ministri.

Analiza përqendrohet në disa aspekte kyçe, duke përfshirë arsyeshmërinë e procesit të organizimit, bazën ligjore, strukturën e brendshme, klasifikimin dhe ri-sistemizimin e vendeve të punës. Çdo segment shqyrtohet në mënyrë sistematike, duke analizuar ndikimin e tij në procesin e riorganizimit të Qeverisë dhe si ndihmon në optimizimin e funksionimit të saj.

Analiza fokusohet në vlerësimin e arsyeshmërisë së ndryshimeve organizative, duke shqyrtuar si aspektet ligjore dhe strukturale ndihmojnë në krijimin e një administrate më efikase dhe funksionale. Do të përfshijë një shqyrtim të thelluar të bazës ligjore që mbështet riorganizimin dhe ndikimin e saj në strukturën e brendshme të administratës.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj analize është një përmbledhje historike e secilës ministri, nga themelimi i saj deri në periudhën aktuale. Ky përmbledhje përfshin

1 Faqe 5 dhe 6, http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2020/03/GLPS-Note-0120-Government-downsizing-.pdf

informacion mbi ministritë që janë shkrirë gjatë procesit dhe numrin e punonjësve të tyre, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi zhvillimet dhe ndikimet që kanë ndodhur.

Në përfundim, analiza ofron rekomandime për përmirësimin e strukturës organizative, duke adresuar sfidat dhe mundësitë e identifikuara gjatë procesit të riorganizimit.

# Nevoja e riorganizimit të Qeverisë

Nevoja për organizim ka qenë e kamotshme për shkak të numrit të madh të ministrive në një shtet me numër relativisht të vogël të banorëve dhe me një territor mjaft kompakt.

Deri në vitin 2020 Kosova cilësohet si vendi me më së shumti ministri dhe zëvendësministra në Ballkan[2].

Përkundër nevojës për riorganizim të Qeverisë duhet shikuar me mjaftë kujdes këtë proces sepse nuk është thjesht proces politik i cili duhet të bazohet vetëm në vullnetin e partisë ose koalicionit për të themeluar Qeverinë dhe përcaktuar numrin e ministrive por të njëjtit i paraprinë disa veprime të cilat të gjithë procesin e bëjnë më kredibil dhe më të saktë në praktikë.

Procesi i riorganizimit të Qeverisë duhet shikuar në disa segmente dhe jo vetëm në aspekt të numrave përkatësisht zvogëlimit të ministrive. Pikësëpari për të pas një proces të mirëfilltë të riorganizimit duhet bërë një analizë të rishikimit të funksioneve të ministrive. Kjo analizë është më se e nevojshme pastaj për të parë se cilat funksione ushtrojnë ministritë veç e veç dhe për te nxjerr pastaj rekomandime të vlefshme se cilat nga funksionet janë më të ngjashme për t`i grumbulluar në një ministri.

Segmenti kryesor që duhet merret parasysh është fushëveprimi i riorganizimit të ministrive. Kjo për faktin se ministritë në vetvete  nuk kanë vetëm aparatin ministror në kuptim të ngushtë por mund të kenë edhe trupa tjerë në përbërjen e tyre që në tersi quhen si sistem ministror. Sipas ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (në vijim LOFASHAP) sistemi ministror përbehet nga ministritë, agjencitë ekzekutive dhe administratat e shërbimeve publike[3]. Për të vendos sisteme ministrore funksionale dhe në pajtim me LOFASHAP është pothuajse e pashmangshme një analizë e funksioneve të gjitha sistemeve ministrore. Kjo është e pashmangshme për shkak se bashkimi i një ministrie me tjetrën ka ndikim të drejtpërdrejt jo vetëm tek ministria (amë) por edhe tek trupat e saj.

Segmenti i kursimit të buxhetit është shumë me rendësi shkaku që me bashkimin e ministrive do të ketë edhe kursim të parasë publike si në paga dhe mëditje ashtu dhe mallra dhe shërbime për kabinetet politike të cilat kanë qenë mjaft të kushtueshme deri më tash.

Çka duhet kushtuar shumë kujdes sidomos pas procesit të riorganizimit të ministrive në rast të zvogëlimit të tyre është klasifikimi i vendeve të punës dhe ri sistemimi i personelit. Kjo është mjaft sfiduese dhe problematike edhe në rastin e Kosovës sidomos këto 3 vitet e fundit e për të cilën do të flasim më gjerësisht në një pjesë

2 https://ekonomiaonline.com/kosova-me-qeverine-me-te-madhe-ne-ballkan-15-ministri-i-mjaftojne/

3 Neni 9, paragrafi 2 I Ligjit Nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684

të veçantë të kësaj analize.

# Si ndodhi riorganizimi i Qeverisë në Kosovë!

Siç u tha më lartë riorganizimi i Qeverisë erdhi si rezultat i një programi politik të disa partive politike por jo bazuar në një analizë të nevojave të cilat i shpjeguam më lartë dhe duke mos përfill elementet siç u shpjeguan më lartë.

Për pasojë, edhe sot ky proces u shpërfaq me të meta të mëdha dhe probleme të cilat u krijuan gjatë riorganizimit të Qeverisë të cilat ekzistojnë vazhdojnë edhe sot .

Problemi i mjaft i madh i identifikuar është bashkimi i panatyrshëm i disa ministrive. Rasti tipik është ai i bashkimit në mes të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Dy ministri me mandate dhe funksione komplet të ndryshme u fuzionuan në një dhe për pasojë edhe sot ka probleme në ushtrimin e funksioneve të fushës së përgjegjësisë së administratës publike. Nga ky shembull kanë dalë disa mësime, ku më kryesori është se edhe pse ka shkrirje (bashkim) klasike në mes të dy ministrive ka një perceptim që njëra ministri është kryesore dhe tjetra dytësore dhe kjo shpërfaqet në të gjitha nivelet e menaxhimin nga pozitat e nivelit të lartë drejtues e deri tek niveli profesional. Kjo logjikë u shpërfaq edhe tek ministritë tjera dhe fatkeqësisht ekziston edhe sot.

Përveç bashkimit të panatyrshëm të disa ministrive, i gjithë procesi riorganizimit ende është pezull dhe i papërfunduar dhe për pasojë shumë pozita të nivelit të mesëm drejtues ende mbahen me pozita të dyfishta kryesisht në strukturat që ofrojnë shërbime administrative dhe mbështetëse. Një qasje e tillë përveç që e paligjshme shkaktoi edhe humbje të linjave të llogaridhënies dhe de motivim të nëpunësve në këto pozitë të cilët edhe kanë dhënë dorëheqje përfundimisht nga shërbimi civil.

Ushtruesit e detyrës janë një problem tjetër madhor që u shfaqen dhe të cilët janë në rritje e sipër dhe është mjaft e çuditshme dhe kontradiktore për faktin se sidomos për nivelin e mesëm dhe të ulët drejtues ka mjaft nëpunës që mbajnë pozita të dublifikuara dhe nuk sistemohen në pozita të lira por ato mbahen me ushtrues detyre.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare mbetet problem madje edhe ligjor sepse edhe në këtë aspekt u bënë disa zgjidhje të paligjshme dhe të cilat do të prodhojnë pasoja në të ardhmen. Këto zgjidhje u bënë duke caktuar persona të autorizuar dhe dhënë autorizime për t`i kryer detyrat dhe përgjegjësitë e ish-ministrive[4], praktikë kjo e cila nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës (përjashtimisht në MPJD që është bërë pjesërisht) është ende i papërfunduar e që është vet qëllimi i një riorganizimi të Qeverisë që është pretenduar të bëhet edhe në Kosovë.

4 Fjala është për strukturat që ofrojnë mbështetje për strukturat funksionale të një ministrie.

# Hapat e domosdoshëm pas riorganizimit të Qeverisë

## Organizimi i brendshëm

Kur jemi te organizimi i brendshëm fjala është për organizimin e një ministrie pra jo të sistemit ministror. Meqenëse në rastin tonë riorganizimi i Qeverisë përfshinë vetëm ministritë do të fokusohemi më shumë tek ky aspekt por duke ngritur edhe disa çështje të cilat janë të nevojshme dhe shpërfaqen pikërisht tek organizimi i brendshëm dhe kanë shtrirje domosdoshmërisht tek i gjithë sistemi ministror.

Organizimi i brendshëm i një ministrie është plani organizativ që i përcakton strukturën dhe funksionimin e strukturave administrative të saj. Organizimi i brendshëm përfshin nivelet hierarkike, detyrat, përgjegjësitë, dhe marrëdhëniet e punës në mes të nëpunësve.

Në procesin e organizimit të brendshëm është e pashmangshme identifikimi i të gjitha funksioneve që ushtron ministria përkatëse. Kjo fillohet me fushën e përgjegjësisë që ka dhe identifikimin e legjislacionit në këtë fushë. Pjesë e analizës se legjislacionit janë si ligjet ashtu edhe aktet nënligjore me qëllim të identifikimi të detyrave dhe përgjegjësive që ka ministria konkrete.

Pasi të bëhet identifikimi i të gjitha funksioneve, detyrave dhe përgjegjësive të dhëna me legjislacion një ministrie duhet filluar të bëhet identifikimi i funksioneve të cilat janë të ministrisë dhe cilat të agjencive ekzekutive ose administratave të shërbimeve të përbashkëta. LOFASHAP përcakton në mënyrë shumë të qartë se cilat nga funksionet ushtrohen nga ministria dhe cilat nga agjencitë ekzekutive ndërsa ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta e lë në kompetencë të administratave të shërbimeve publike. LOFASHAP shumë mirë e ka precizuar përgjegjësinë e ministrisë për hartimin e politikave publike, për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë[5]. Se çka konsiderohet hartim i politikave LOFASHAP jep këtë definim "Funksioni i hartimit të politikave është përgatitja e politikave publike, hartimin i akteve ligjore, miratimi i akteve nënligjore dhe përcaktimi i standardeve të detyrueshme"[6]. Pra vetëm sipas kësaj logjike mund të fillohet ndarja e funksioneve në ato që janë të rezervuara vetëm për ministrinë dhe të tjerat për trupat tjerë brenda ministrisë (Agjencisë Ekzekutive dhe sipas rastit të një administrate të shërbimeve publike). Ndarja dhe definimi i funksioneve është shumë i nevojshëm për të vendosur një sistem të mirëfilltë të përformancës ashtu siç përcaktohet me LOFASHAP. Definimi i këtij raporti përkatësisht "njësisë përgjegjëse" është krucial për të vendosur sistemin e përformancës dhe mbikëqyrjen e një agjencie ekzekutive që është pjesë e një ministrie.

Organizimi i brendshëm i një ministrie është thelbësor për të siguruar që ministria të punojë në mënyrë efektive dhe të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët. Për të arritur këtë, organizimi i brendshëm duhet të përfshijë një strategji të qartë dhe të qëndrueshme, të cilën të gjithë nëpunsit e ministrisë duhet ta kenë të qartë dhe të parashikueshme.

Një organizim i mirë i brendshëm do të përfshijë një strukturë hierarkike të qartë

5 paragrafi 1 i nenit 11 i LOFASHAP, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684
6 Ibid, paragrafi 1.1 i nenit 2

dhe të qëndrueshme, me nivele të ndryshme të drejtimit, duke filluar nga ministri e deri tek niveli më i ulët profesional. Përveç kësaj, organizimi i brendshëm duhet të përfshijë edhe një përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësive për secilën strukturë administrative të ministrisë, pozitë në strukturën hierarkike, duke përfshirë edhe objektivat dhe synimet e secilit departament dhe divizion.

Për t`u arritur kjo duhet të bëhet një ndarje e mirë në mes funksioneve të zbërthyera në procese dhe pastaj në punë konkrete. Kjo do të ndihmonte në një organizim më të saktë dhe të bazuar në provë sepse sipas këtij parimi nënkuptohet se strukturat themelohen duke bashkuar punët dhe proceset për të t`i kontribuar një funksioni të ministrisë të dhënë me ligj.

Akti përmes të cilit duhet bërë organizimi i brendshëm i një ministrie është rregullorja për organizimin e brendshëm. LOFASHAP jep edhe elementet e detyrueshme që duhet të përmbaj rregullorja për organizimin e brendshëm që përfshinë:

- struktura funksionale;

- organogrami i detajuar i institucionit, që përfshin edhe klasën e secilës pozitë të

punës dhe grupin e çdo pozite të kategorisë profesionale në pajtim me dispozitat për klasifikimin në Shërbimin Civil sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë ;

- misionin dhe përshkrimin e punës të çdo njësie të brendshme administrative[7]

LOFASHAP përcakton procedurën dhe autoritetin që bënë miratimin përfundimtar të rregullores për organizimin e brendshëm që në rastin e ministrive është Kryeministri në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat[8]. Filtrat e vendosur (MPB dhe MF) kanë për qëllim sigurimin e Kryeministrit para miratimit të rregullove të organizimit të brendshëm nëse janë plotësuar standardet e organizimit të brendshëm sipas Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura nga ministri përgjegjës për administratë publike dhe në anën tjetër për të konfirmuar buxhetin nga ministri i financave.

Rregulloret për organizimin e brendshëm kanë qenë të nevojshme të hartohen shkaku dy situatave të cilat kanë sjell domosdo plotësimin dhe ndryshimin e tyre. E para ka qenë obligim ligjor që për shkak të ndryshimit të bazës ligjore përkatësisht legjislacionit të organizimit të brendshëm të bëhet edhe plotësimi dhe ndryshimi i rregulloreve për organizimin e brendshëm. Për këtë qëllim edhe është përcaktuar afati 6 mujor për hartimin dhe miratimin e tyre[9]. Ky afat që nga janari i vitit 2020 disa herë është shkelur dhe vetëm disa ministri kanë arrit që miratojnë rregulloret e organizimit të brendshëm. E dyta shkaku i riorganizimeve të Qeverisë të cilat ndodhen gjatë vitit 2020 dhe 2021 ndryshime këto që duhet të reflektohen pikërisht në aktin (Rregulloren) e organizimit të brendshëm.

Aktualisht rregulloret për organizimin e brendshëm kanë miratuar: Zyra e Kryeministrit (ZKM) , Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) , Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

7 Ibid, paragrafi 1 I nenit 28.

8 Ibid, Paragrafi 3 nenit 28.

9 Neni 12 I Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura

(MPJD). Ministritë tjera janë në fazën e hartimit të rregulloreve të brendshme dhe kanë dështuar t`i miratojnë rregulloret për organizimin e brendshëm përkundër që ekziston një afat i cili përcaktuar dhe që është obligim ligjor.

## Klasifikimi i vendeve të punës

Proces shumë i rëndësishëm dhe paralel me organizimin e brendshëm është procesi i klasifikimit të vendeve të punës i cili asnjëherë nuk ka ndodhur deri më tani përkundër ekzistimin të legjislacionit dhe afateve të përcaktuara për këtë qëllim.

Klasifikimi i vendeve të punës është kërkesë e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës (tutje: RrKVP) dhe shërben për të përcaktuar saktë secilën pozitë duke krahasuar përshkrimin e detyrave me karakteristikat e secilës klasë, e cila bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kërkesave të përgjithshme formale të kërkuara të një pozite konkrete.

Analiza e faktorëve të klasifikimit është një proces që ndihmon në identifikimin e atributeve dhe kritereve që duhen marrë në konsideratë për të klasifikuar një pozitë pune në një klasë të një kategorie të caktuar. Kjo analizë bëhet për çdo faktor duke u mbështetur në përshkrimin e punës për pozitën përkatëse.

Në përgjithësi, procesi i klasifikimit të vendeve të punës është parakusht në zgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm për një pozitë konkrete të punës.

Sa i përket karakteristikave që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, ato krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë.

Si rregull, pozita vlerësohet dhe klasifikohet në atë klasë me karakteristika që ka më shumë ngjashmëri me faktorët e një pozite specifike. Ky proces vlerësimi dhe klasifikimi bazohet në një sërë karakteristikash që ka secila klasë duke i krahasuar të njëjtat me përgjegjësitë dhe detyrat që ka një pozitë konkrete.

Procesi i klasifikimit të vendeve të punës është mjeti dhe parakushti themelor për të pas një organizim të brendshëm të mirëfilltë dhe në pajtim me ligjin. Meqenëse pjesa e klasifikimit të vendeve të punës është proces që fillon dhe përgatitet paralelisht me procesin e organizimit të brendshëm, edhe procedura si dhe organi kompetent për miratimit të këtij procesi është i njëjtë. Pjesë e detyrueshme e rregullores për organizimin e brendshëm është edhe organogrami i cili është paraqitur si Shtojca 1 e Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura.

Deri më tash asnjë ministri nuk ka përfunduar procedurën e klasifikimit të vendeve të punës, gjë që e bën të pamundur fillimisht plotësimin e organogramit që është pjesë e detyrueshme e Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, përcaktimin adekuat të pagave dhe zhvillimin e procedurave për plotësimin e vendeve të lira të punës për shkak të mungesë së 2 elementeve kryesore siç janë klasa dhe grupet e pozitave të punës.

## Ri sistematizimi i nëpunësve/punëtorëve

Ligji për zyrtarët publik parashikon dispozita për menaxhimin e zhvendosjes së nëpunësve civilë, pozitat e të cilëve preken nga shfuqizimi ose ristrukturimi

i institucioneve publike. Sipas nenit 1, kur pozicioni i nëpunësit civil hiqet për shkak të mbylljes ose ristrukturimit institucional, ai ka të drejtë të transferohet në një pozicion tjetër brenda shërbimit civil, për sa kohë që roli i ri bie në të njëjtën kategori. Kjo dispozitë garanton sigurinë e punës për nëpunësit civilë në rastet kur ndryshimet institucionale mund të çojnë ndryshe në papunësi, duke ruajtur vazhdimësinë dhe stabilitetin në shërbimin civil.

Paragrafi 2 i nenit 66 përshkruan rrethanat specifike në të cilat një nëpunës civil mund të transferohet. Së pari, një nëpunës civil mund të transferohet brenda të njëjtit institucion nëse ka pozicione të përshtatshme vakante. Së dyti, nëse institucioni është bashkuar ose ndarë në subjekte të tjera, nëpunësi civil mund të riemërohet në institucionin e ri që ka thithur funksionet e institucionit fillestar, ose në një institucion që ka marrë përsipër detyra specifike të mbajtura më parë nga subjekti i shfuqizuar. Për më tepër, ai lejon transferimet në agjencinë përkatëse ekzekutive të një institucioni të ristrukturuar. Së fundi, në rastet kur nuk disponohen pozicione të përshtatshme brenda institucionit ose kategorisë fillestare, nëpunësi civil mund të transferohet në një institucion tjetër brenda shërbimit civil.

Ligji përcakton edhe rolin e Komisionit të Ristrukturimit, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 66. Ky komision është përgjegjës për vlerësimin e vendeve vakante të disponueshme në shërbimin civil dhe identifikimin e pozicioneve që përputhen me kualifikimet e nëpunësve civilë të zhvendosur. Komisioni shqyrton kualifikimet e punonjësve të prekur dhe propozon transferime të përshtatshme bazuar në këto kritere, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë dhe sistematike të nëpunësve publikë në përgjigje të ndryshimeve institucionale.

Sipas ligjit (neni 66, paragrafi 4), vendimi përfundimtar për transferimin e nëpunësit civil merret nga autoriteti përgjegjës, bazuar në rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit. Kjo siguron që procesi i transferimit të jetë transparent dhe i bazuar në kritere objektive, duke marrë parasysh si nevojat e institucionit publik ashtu edhe kualifikimet e nëpunësit civil. Ligji fuqizon autoritetin përgjegjës për të marrë vendimin përfundimtar në mënyrë që të sigurojë që procesi i transferimit të jetë efektiv dhe në interesin më të mirë të shërbimit publik.

## Pasojat e mungesës së riorganizimit dhe ri sistematizimit

Mos organizimi sistematizimi i nëpunësve civil edhe pse obligim ligjor në praktikë ka shkaktuar mjaft probleme si praktike ashtu edhe ligjore e një nga to është ekzistimi i strukturave të dyfishta të cilat ofrojnë shërbime për njësitë organizative që ushtrojnë funksione që lidhen me mandatin e një ministrie. Problemet praktike ekzistojnë sepse ende nuk ka një fushëveprim të qartë në mes të ministrive që janë bashkuar dhe për pasojë kjo reflektohet pikërisht tek strukturat mbështetëse dhe disa nga detyrat mund të mos përmbushen ose të ketë konflikt në mes të strukturave të njëjta të cilat mendojnë që janë kompetente. Në aspektin e menaxhimit të përditshëm, kjo i ka shërbyer politikës ditore që të "shfrytëzoj" strukturën paralele më të përshtatshme e cila është më dëgjueshme ndaj saj. Problemet ligjore janë të natyrës që ekzistimi i këtyre strukturave paralele shkakton shpenzime të parasë publike që është në kundërshtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike. Tjetër problem ligjor status quo e tyre kur dihet se tashmë e 3 vite është marr një vendim për shuarjen e disa ministrive ndërsa në praktike strukturat mbështetëse ende ekzistojnë që e bën të kontestueshëm vet mandatin e tyre dhe veprimet që janë marrë në bazë të tij.

Një tjetër problem i shkaktuar për shkak të mungesës së riorganizimit dhe ri sistematizimit të vendeve të punës është dukuria e ushtruesve të detyrës e cila do të trajtohet në këtë pjesë.

## Ekzistimi i strukturave të dyfishta

**Departamentet ligjore (DL)**, që si mision kanë koordinimin e procesit të hartimit të legjislacionit dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare nga fushëveprimi e një Ministrie, duke siguruar respektimin e teknikave dhe standardeve për hartimin e legjislacionit, sigurimin e përafrimit të legjislacionit të Ministrisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe ofrimin e mbështetjes profesionale, këshillave ligjore dhe rekomandimeve për strukturat tjera në kuadër të Ministrisë. Këto struktura në shumicën e ministrive ekzistojnë si struktura paralele. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive është bërë në mënyrë faktike në bazë të fushëveprimit që ka pas më herët ministria p.sh. në rastin e MMPHI si ministri e re, për ish MMPH detyrat dhe përgjegjësitë ushtrohen nga Departamenti Ligjor i saj ndërsa për ish MI nga Departamenti ligjor i saj.

E njëjta situatë ndodhë edhe me strukturat që janë nën këto Departamente siç janë: Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit; dhe Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit. Këto Struktura ekzistojnë në çdo ministri ndërsa tek ministrit që kanë qenë objekt i riorganizimit këto funksionojnë si struktura paralele.

**Departamentet për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)**, janë struktura horizontale brenda ministrive që kanë për qëllim koordinimin e proceseve që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian, koordinimin e procesit të hartimit të dokumenteve të politikave, programeve e projekteve për bashkëpunim, koncept dokumenteve, planit vjetor të punës dhe dokumenteve tjera, si dhe të koordinojë proceset brenda Ministrisë për bashkëpunim ndërkombëtar dypalësh dhe shumëpalësh me partnerët ndërkombëtarë. Këto struktura në disa ministri ende funksionojnë si të dyfishta dhe paralele.

**Departamentet e Shërbimeve të Përgjithshme (DSHP)**, është struktura e tjetër e cila vazhdon të ekzistoj si e duplifikuar dhe paralele. Këto struktura janë në secilën ministri të krijuara për të ofruar kushte fizike të punës, pajisje të nevojshme dhe shërbimet mbështetëse për kryerjen e detyrave dhe të mbështesin departamentet tjera përmes ofrimit të shërbimeve të TI-së, mirëmbajtjes, logjistikës, administrimit të dokumenteve dhe shërbimet e tjera të ngjashme. Edhe në këtë rast ndarja e punëve është bërë në mënyrë faktike dhe dhe secila DSHP ushtron detyrat që i ka pas tek ish ministria që ekzistuar më herët. Një problem ligjor megjithatë ekziston tek këto departamente shkaku që të njëjtat kanë në menaxhim edhe një pjesë të financave të ministrisë, pra një kod buxhetor e që me shkrirjen e disa ministrive në një dhe pa definimin e pozitave dhe mbajtësve të tyre është mjaft problematike dhe e diskutueshme nëse këta nëpunës civil në mënyrë të ligjshme mund të shpenzojnë buxhetin për at kod buxhetor! Si rregull, në kuadër të DSHP-ve para hyrjes në fuqi të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore kanë ekzistuar 3 divizione: Divizioni për Buxhet dhe Financa, Divizioni i Burimeve Njerëzore, Divizioni i TI-së dhe Shërbimeve Logjistike. Dy të parat janë struktura të mëvetësishme ndërsa e Divizioni i tretë mbetet në kuadër të DSHP-ve.

Në katë aspekt duhet shumë me kujdes vlerësuar nëse është e nevojshme ekzistimi i mëtutjeshëm i DSHP-ve si departament apo të njëjtat mund të funksionojnë si divizion.

**Divizionet e Auditimit**, janë struktura që kryejnë aktivitete këshillëdhënëse të pavarura dhe objektive në ofrimin e sigurisë së arsyeshme, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të subjektit të sektorit publik, e që ndihmon subjektin për përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe për të përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Si pasojë e riorganizimit të Qeverisë këto struktura vazhdojnë të qëndrojnë si të duplifikuara dhe paralele, pra secila nga këto struktura ushtron detyrat që ka pas për ish ministritë.

**Divizionet e Prokurimit (DP)**, janë struktura standarde në secilën ministri të cilat kryejnë aktivitetet e prokurimit dhe shfrytëzimit të fondeve të Autoritetit Kontraktues në mënyrë sa më transparente, të drejtë dhe efikase, në përputhje të plotë me Ligjin dhe me rregullat e Prokurimit Publik. Edhe këto struktura ende ekzistojnë si të duplifikuara dhe paralele në secilën prej ish ministrive. Gjatë ekzistimit të këtyre strukturave si paralele ka raste në praktikë që asnjëri nga udhëheqësit e DP nuk është autorizuar të vazhdoj të kryej detyrat por ne vend të tyre është caktuar një person i tretë si ushtrues detyre.

**Divizionet e Burimeve Njerëzore (DBNJ)**, janë struktura që janë përgjegjëse për të siguruar menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit, si dhe ushtrojnë funksionet e kompetencat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën e burimeve njerëzore. DBNJ janë struktura shumë të rëndësishme sepse të njëjtat janë përgjegjëse drejtpërdrejt sipas legjislacionit për zyrtarët publik, prandaj edhe definimi i statusit të tyre është i domosdoshëm për të përcaktuar ligjërisht kush është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore brenda ministrisë. DBNJ janë përgjegjëse gjithashtu sa i përket procesit të organizimit të brendshëm, klasifikimit të vendeve të punës, hartimit të përshkrimit të detyrave të punës por edhe vet procesit të ri sistematizimit. Në disa ministri që kanë qenë subjekt i bashkimit ose shuarjes, DBNJ-të ende vazhdojnë të funksionojnë si më herët pra duke kryet detyrat dhe përgjegjësitë për ish ministritë.

**Divizionet për buxhet dhe financa (DBF)**, janë struktura mbështetëse të ministrisë për zbatimin e politikave dhe procedurave standarde te kontabilitetit në pajtim me ligjet në fuqi, rregulloret që lidhen me fushën e buxhetit dhe financave. Këto struktura kanë qenë të ndryshme ndër vite dhe më herët kanë pas statusin e zyrës. Me legjislacionin e ri mund të themelohen si divizion ose departament varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti që kanë[10]. Edhe këto struktura vazhdojnë të ekzistojnë si të duplifikuara dhe paralele në disa ministri.

**Divizioni për Komunikim Publik**, janë struktura që ndërmarrin veprime për prezantimin e politikave ministrore, nëpërmjet komunikimit në kohën e duhur, në mënyrë që publiku të informohet për politikat ministrore për të drejtat e përgjegjësitë e tij ndaj institucioneve, por edhe për të shprehur pikëpamjet e tij duke komunikuar me vendimmarrësit. Edhe këto divizione në disa ministri funksionojnë si të duplifikuara dhe paralele.

10 Neni 21 I Ligjit Nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684

## Ushtruesit e detyrës

Sipas nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (LZP), nëse një pozitë mbetet e lirë e njëjta mund të plotësohet me ushtrues detyre për 6 muaj, me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj të tjerë (1 vit). Megjithatë, pas një viti të hyrjes në fuqi të ketij ligji, një numër i lartë i pozitave drejtuese[11] (Sekretar të Përgjithshëm, Drejtor Departamenti dhe Udhëheqës i Divizionit) vazhdojnë të mbahen me ushtrues detyre edhe pse afati ligjor ka skaduar. Tejkalimi i këtij afati përveç që është paligjshmëri ka edhe një pasojë  juridike që është shpallja e paligjshme e vendimeve të marra nga ushtruesi/ja i/e detyrës.

# Rekomandimet

- Riorganizimi i Qeverisë në të ardhmen të fokusohet në sistemet ministrore që nënkupton ministritë dhe agjencitë në kuadër të saj dhe që i paraprinë një analizë e rishikimit funksional të tyre për të ardhë në opsione të sakta dhe të mundshme për racionalizimin e tyre;
- Sa më shpejt të përfundoj procesi i organizimit të brendshëm i ministrive në pajtim me legjislacionin në fuqi. Gjatë organizimit të brendshëm të ministrive në rastet kur të njëjtat kanë në përbërje edhe trupa tjerë (agjenci ose administrata të shërbimeve publike) të bëhet një ndarje dhe definim i funksioneve të tyre në pajtim me LOFASHAP për të mundësuar vendosjen e linjave të qarta të llogaridhënies;
- Paralelisht me organizimin e brendshëm të bëhet edhe klasifikimi i vendeve të punës në pajtim me legjislacionin në fuqi. Në shtojcën e rregullores së organizimit të brendshëm të jetë e përcaktuar pozita, klasa dhe grupi i specializimit elemente këto të domosdoshme për zbatimin e plotë të legjislacionit për zyrtarët publik;
- Ri sistemimi i nëpunësve është i domosdoshëm për vazhduar funksionimin normal të ministrive dhe për të shmangur ekzistimin e strukturave të dyfishta.
- Eliminimi i strukturave të dyfishta për të parandaluar dëmtimin e buxhetit të shtetit shkaku i pagesës së udhëheqësve në këto pozita;
- Të shmanget fenomeni i funksionimit me Ushtruesë të Detyrës dhe për këto pozita të shpallen konkurse të rregullta në pajtim me legjislacionin në fuqi duke siguruar meritokraci në përzgjedhjen e nëpunësve në këto pozita.

11 Niveli i lartë, i mesëm dhe i ulët drejtues

# PJESA E ANALIZËS TË SECILËS MINISTRI

## MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË (MINT)

### Historiku

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është themeluar me hyrjen në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.[12] Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nga viti 2021 i është bashkuar gjithashtu një dikaster i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me c'rast emërtohet Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë. [13]

### Organizimi

Rregullorja (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përcakton numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me përjashtim të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë; Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës; Agjencisë të Pronësisë Industriale; Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit; Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës; Agjencisë së Standardizimit të Kosovës dhe Inspektorati i Tregut ne kuadër te MINT gjithsej një qind e tetëdhjetë e pesë (185)[14] nga një qind e tetëdhjetë e tetë (188) sa ishte paraparë me Rregulloren Nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.[15] Ministria e Industrisë dhe Tregtisë deri në bashkimin me Ndërmarrësnsë përbëhej nga tetë (8) Departamente dhe njëzetë (20) Divizione gjithsej ndërsa rregullorja e lartpërmendur e cila shfuqizon rregulloren e mëparshme parasheh përbërjen si në vijim: Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, katërmbëdhjetë (14) Departamente, njëzet e dy (22) Divizione.

### Pozitat drejtuese

Rregullorja (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë pavarësisht se është në fuqi që nga viti 2022, e njejta nuk ka gjetur implementim. Andaj, shërbimi civil në MINT pavarësisht riogranizimit të brendshëm vazhdon të funksionojnë bazë të rregullores së shfuqizuar pjesërisht tashmë.

12 Rregullore e UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca III (e shfuqizuar), E qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_19.pdf

13 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vendim për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. I qasshëm në: 2021_03_25_VendimperzgjedhjeneQeveriseseKosoves22.03.2021_rYexDNvAC6 (3)[2075].pdf

14 Rregullorja (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Neni 4, prg. 2, E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=64279

15 Rregullore (QRK) Nr. 11/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 36/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Neni 3, prg, 2. E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=64279

Me sa u tha më lart, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nga 8 departamentet se sa janë pozita të rregullta[16] udhëheqëse dhe sa pozita janë me ushtrues detyre. Ndërsa pozita e sekretarit të përgjithshëm është me ushtrues detyre dhe në tri vitet e fundit këtë pozitë e kanë udhëhequr nëntë (9) persona të ndryshëm. Ndërsa, sa i përket njësive organizative, nga 22 divizionet e paraqitura në rezultate, 8 nga to ushtrohen nga zëvendësues.[17]

## Gjendja pas ristrukturimit

Rregullorja për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë[18] ka hyrë në fuqi më 7 tetor të vitit 2022 por në praktikë ende nuk është ndërmarrë ndonjë veprim konkret për implementimin e plotë të saj. Ministria nuk ka ofruar të dhëna të përditësuara.

Tabela […]

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | wNëpunësit aktual |
|---|---|---|---|
| **Kabineti I Ministrit** | | | 18 |
| **🔴 Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | Divizioni i Auditimit të Brendshëm | 2 | 1 |
| | Divizioni i Prokurimit; | 4 | 3 |
| | Divizioni për Komunikim Publik | 3 | 3 |
| **🔴 Departamenti i Tregtisë** | 🔴 Divizioni për Politika Tregtare | 4 | 3 |
| | 🔴 Divizioni për tregti në shërbime | 5 | 2 |
| | Divizioni për Mbrojtjen e Tregut | 3 | 2 |
| **Departamenti i Industrisë** | 🔴 Divizioni për Politika Industriale | | 5 |
| | Divizioni për Infrastrukturë të Cilësisë | 3 | 1 |
| **Departamenti i Turizmit** | 🔴 Divizioni për Hartimin e Politikave Turistike | 4 | 1 |
| | Divizioni për Promovim, Zhvillimin e Produktit, Bizneseve dhe Standardeve Cilësore | 5 | 2 |
| **Departamenti i Rezervave Shtetërore** | Divizioni për Rezerva Shtetërore të Mallrave | 3 | 3 |
| | Divizioni për Rezerva Obligative të Naftës së Papërpunuar | 2 | 2 |
| **Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës dhe Mallrave Strategjike** | Divizioni për Tregti me Mallra Strategjike | 3 | 3 |
| | Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit | 3 | 4 |

16 Pozitë e rregulltë nënkupton kur pozita ushtrohet nga nëpunësi civil i cili është emëruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

17 Informata të ofruara nga MPB, pas kërkesës së GLPS për qasje në dokumente zyrtare.

18 Rregullorja (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=64279

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave** | Divizioni për Integrime Evropiane | 2 | 2 |
| | 🔴 Divizioni për Koordinim të Politikave | 2 | 2 |
| **Departamenti Ligjor** | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 3 | 2 |
| | Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | 2 | 2 |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | 🔴 Departamenti për Buxhet dhe Financa | 8 | 7 |
| | 🔴 Divizioni i Burimeve Njerëzore | 5 | 4 |
| | 🔴 Divizioni për Transport dhe Logjistikë | 9 | 6 |
| | Divizioni i TI-së, Dokumenteve dhe Shërbimeve | 9 | 2 |
| 🔴 Ushtrues i detyrës | Totali | 90 | 65 |

# MINISTRIA PËR KTHIM DHE KOMUNITETE (MKK)

## Historiku

Konflikti i vitit 1999 përvec pasojave notore, rezultoj edhe në ikjen masive të shqiptarëve por edhe të komuniteteve të tjera nga Kosova. Pas vitit 1999, është shënuar një kthim i konsiderushëm I shqiptarëve në Kosovë mirëpo në të njejtën kohë një ikje masive e serbëve dhe komuniteteve tjera jo shumicë. Andaj, me qëllim të lehtësimit të kthimit, UNMIK ka parashtruar kërkesën e themelimit të një ministrie te vecantë përmes promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komunitetit. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit është themeluar me hyrjen ne fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/50 mbi Themelimin e Minsitrive të Reja dhe krijimin e Posteve të Zëvendëskryeministrit dhe të Zëvëndësministrave në Degën e Ekzekutivit më 24 Janar 2005.[19]

Me themelimin e Ministrisë për Kthim dhe Komunitet, u bartën disa nga përgjegjësitë e Zyrës së Komuniteteve e cila ka vazhduar me aktivitetin e saj që nga ajo kohe e gjerë më sot pranë Zyrës së Kryeministrit.

## Organizimi

Rregullorja Nr. 40/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim përcakton numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, gjithsej tetëdhjetë e gjashtë (86)[20].

19 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/50 mbi Themelimin e Minsitrive të Reja dhe krijimin e Posteve të Zëvendëskryeministrit dhe të Zëvëndësministrave në Degën e Ekzekutivit (e shfuqizuar). E qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2004regs/RA2004_50.pdf

20 Rregullore Nr. 40/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, *Neni 3, prg. 2.* E qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10358

Ministria për Kthim dhe Komunitete përbëhet nga Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, katër (4) Departamente, njëmbëdhjetë (11) Divizione.[21]

## Pozitat drejtuese

Rregullorja Nr. 40/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nga 4 departamentet, të gjitha udhëhiqen nga pozita të rregullta, duke përfshirë gjithashtu Kabinetin e Ministrit qe udhëhiqet nga pozitë e rregullt22 si ndërsa sekretari është ushtrues detyre.

Ndërsa, sa i përket njësive organizative, të gjitha divizionet, përveç divizionit për komunikim me publikun, figurojnë të jenë pozita të rregullta[23].

Gjendja pas ristrukturimit

Ministria për Kthim dhe Komunitete nuk është subjekt i ristrukturimit

Tabela [..]

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|
| **Kabineti I Ministrit** | | | 17 |
| **● Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | Divizioni i Auditimit të Brendshëm | 3 | 0 |
| | Divizioni i Prokurimit; | 5 | 3 |
| | ● Divizioni për Komunikim Publik | 4 | 1 |
| | Stafi ne zyren e Sekretarit te Përgjithshëm | 3 | 4 |
| **● Departamenti për Planifikim të Politikave dhe Analiza** | Divizioni për Planifikim të Politikave | 7 | 9 |
| | Divizioni për Komunitetet e Disfavorshme | 4 | 6 |
| | Divizioni për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave | 2 | 1 |
| **Departamenti për Menaxhim dhe Monitorim të Projekteve** | Divizioni për Kthim dhe Komunitete | 6 | 13 |
| | Divizioni për Projekte | 5 | 4 |
| **Departamenti Ligjor** | | 4 | 2 |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | Divizioni për Buxhet dhe Financa | 6 | 4 |
| | Divizioni i Burimeve Njerëzore | 10 | 7 |
| | Divizioni i TI-së dhe Shërbimeve Logjistike | 23 | 18 |

● Ushtrues i detyrës — Totali 90 65

21 *Ibid, Neni 6.*

22 Pozitë e rregulltë nënkupton kur pozita ushtrohet nga nëpunësi civil i cili është emëruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

23 Informata të ofruara nga MPB, pas kërkesës së GLPS për qasje në dokumente zyrtare;

# MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME (MBP)

## Historiku

Ministria e Punëve të Brendshme është themeluar me hyrjen në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/53 të datës 20 dhjetor 2005 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë[24].

## Organizimi

Rregullorja (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëvë të Brendshme përcakton numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjithsej treqind e nëntëdhjetë e pesë (395)[25] nga tetëqind e tridhjetë e një (831) sa ishte paraparë me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 36/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme[26].

Ministria e Punëve të Brendshme deri në fuzionimin me Ministrinë e Administratës Publike përbëhej gjithsej nga shtatë (7) Departamente dhe tridhjetë (30) Divizione ndërsa rregullorja e lartpërmendur e cila shfuqizon njëherazi rregulloren e mëparshme parasheh përbërjen si në vijim: Kabineti i Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, trembëdhjetë (13) Departamente, pesëdhjetë e një (51) Divizione.

## Pozitat drejtuese

Rregullorja (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëvë të Brendshme ani pse është në fuqi që nga viti 2021, e njejta nuk ka gjetur implementim. Andaj, shërbimi civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme pavarësisht riogranizimit të brendshëm vazhdon të veproj me bazë në rregulloren e shfuqizuar pjesërisht tashmë.

| **Departamenti Ligjor** | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 3 | 3 |
| | 🔴 Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Bashkëpunimin ndër-institucional | 2 | 4 |
| **Departamenti per Buxhet dhe Financa** | Divizioni per Buxhet | 3 | 4 |
| | Divizioni për Financa | 13 | 10 |
| | Divizioni i TI-së dhe arkiv | 15 | 12 |
| 🔴 Ushtrues i detyrës | Totali | 116 | 119 |

# MINISTRIA E DREJTËSISË

## Historiku

Ministria e Drejtësisë fillimisht është krijuar si Departamenti Administrativ për Drejtësi përmes Rregullores së UNMIK-ut UNMIK/REG/2000/15, të datës 21 mars 2000. Si i tillë, ky departament ka qenë përgjegjës për udhëheqjen e përgjithshme të çështjeve që kishin të bëjnë me sistemin gjyqësor dhe shërbimin korrektues. Me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Departamenti Administrativ për Drejtësi është shëndrruar në Ministrinë e Drejtësisë të cilës i është zgjeruar fushëveprimtaria në shumë aspekte. Aktualisht Ministria e Drejtësisë ndër të tjera bën përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ofron ekspertiza dhe ekzaminime mjeko - ligjore në pajtim me ligjin, licencon dhe mirëmban regjistrin e noterëve, përmbaruesve privat, ndërmjetësuesve, dhe administratorëve falimentues, etj.

## Organizimi

MD ka gjithsejt 6 departamente dhe 5 divizione me aktualisht 175 të punësuar.

## Ushtruesit e Detyrës

Nga 6 departamente 1 pozitë udhëhiqet me ushtrues detyre, ndërsa departamentet

tjera udhëhiqen nga persona të emëruar në pozita të rregullta[60].

## Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Drejtësisë ka mbetur e paprekur nga procesi i ristrukturimit.

Tabela [...]

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|
| **Kabineti i Ministres** | | | 17 |
| **● Zyra e Sekretarit te Përgjithshëm** | Zyra e Sekretarit | | 2 |
| | ● Divizioni për Buxhet dhe Financa | 9 | 9 |
| | Divizioni i Prokurimit | 4 | 3 |
| | Njësia për Auditim të Brendshëm | 3 | 3 |
| | ● Divizioni për Komunikim Publik | 3 | 1 |
| | Divizioni për Burime Njerëzore | 6 | 2 |
| | Njësia për te Drejtat e Njeriut | | 2 |
| **Departamenti për Financa dhe Shërbime te Përgjithshme** | ● Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike | 13 | 19 |
| **● Avokatura Shtetërore** | Zyra e Avokaturës Shtetërore | | 14 |
| **● Departamenti i Mjekësisë Ligjore** | Zyra e drejtorit | | 7 |
| | ● Divizioni për Hulumtime, Ndërtimin e Kapaciteteve, Shërbime të Përgjithshme dhe Logjistikë për Mjekësi Ligjore | | 9 |
| | Divizioni për Identifikim, Koordinim dhe Përkrahje | | 10 |
| | Divizioni për Mjekësi Ligjore | | 31 |
| **● Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim te Politikave** | Zyra e drejtorit | | 2 |
| | Divizioni për Integrime Evropiane | 2 | 3 |
| | Divizioni për Koordinim te Politikave | 2 | 2 |
| **Departamenti për Profesione te Lira** | Zyra e drejtorit | | 1 |
| | Divizioni për Jurisprudencë, Ndërmjetësim dhe Administratorët Falimentues | 2 | 2 |
| | Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat | 3 | 3 |

60 Pozitë e rregulltë nënkupton kur në pozita ushtrohet nga nëpunsi civil I cili është emruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje te Viktimave te Krimit** | Zyra e drejtorit | | 1 |
| | Divizioni për Drejtësi Tranzicionale | | 3 |
| | Divizioni për Mbështetje te Viktimave te Krimit | | 3 |
| **Departamenti Ligjor** | Zyra e drejtorit | | 1 |
| | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 9 | 3 |
| | Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | 3 | 11 |
| **Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar** | Zyra e drejtorit | | 1 |
| | Divizioni për Bashkëpunim në Çështjet Penale dhe Civile | 10 | 7 |
| | Divizioni për Hartim dhe Negocim të Marrëveshjeve Ndërkombëtare Juridike | 12 | 1 |
| **Inspektorati për inspektimin e punës së SHKK-së** | | | 7 |
| **Divizioni për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara** | | | 5 |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | Njësia  për Burime Njerëzore<br>Divizioni për Buxhet dhe Financa<br>Divizioni për zhvillimin dhe përgatitjen e testeve për patën shofer<br>Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike | 24 | 33b |
| ● Ushtrues i detyrës | Totali | 81 | 168 |

# MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

## Historiku

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit fillimisht është themeluar me Rregulloren Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, të UNMIK, të datës 13 shtator 2001, me mandat të krijimit të politikave të veprimit dhe zbatimit të legjislacionit për të përkrahur sektorin e kulturës, duke përfshirë programet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përkrahjen e lidhjeve kulturore dhe formimin e klubeve kulturore, grupeve, shoqatave dhe shoqërive kulturore; krijon politikën e veprimit dhe strategjitë për sektorin e rinisë, duke

përfshirë identifikimin e grupeve specifike të rrezikuara, zhvillimin e programeve për shqyrtimin e nevojave të tyre dhe përkrahjen e klubeve, grupeve dhe shoqërive rinore; Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për formimin dhe funksionimin e organizatave, shoqërive, klubeve dhe grupeve sportive; kujdeset dhe ndihmon komunikimin dhe kontaktet mes personave dhe organizatave përmes aktiviteteve, siç janë zhvillimi, përhapja dhe këmbimi i materialeve informative, kulturore, arsimore dhe materialeve të tjera; përkrah aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore si dhe lidhjet me anëtarët e të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore, duke përfshirë edhe ata që jetojnë përkohësisht ose përgjithmonë në Kosovë (banorë jorezidentë); dhe mban lidhje me rrjetat e themeluara të jorezidentëve, që trajtojnë nevojat kulturore të mërgimtarëve dhe të të kthyerve. E njejta ministri vazhdon të ketë të njejtën veprimtari.

## Organizimi

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka gjithsejt 7 departamente dhe 19 divizione me aktualisht 147 të punësuar.

## Ushtruesit e Detyrës

Nga 7 departamente 2 pozita udhëhiqet me ushtrues detyre, ndërsa departamentet tjera udhëhiqen nga persona të emëruar në pozita të rregullta[61].

Momentalisht edhe Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm udhëhiqet me ushtrues detyre.

## Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka mbetur e paprekur nga procesi i ristrukturimit të fundit.

Tabela [...]

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|
| **Kabineti I Ministrit** | | | 18 |
| **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore | 5 | 5 |
| | Divizioni i Auditimit të Brendshëm | 2 | 2 |
| | Divizioni i Prokurimit; | 5 | 7 |
| | Divizioni për Komunikim Publik | 4 | 4 |
| **Departamenti Ligjor** | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 6 | 4 |
| | Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | 5 | 2 |

61 Pozitë e rregulltë nënkupton kur në pozita ushtrohet nga nëpunsi civil I cili është emruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti I Rinisë** | Divizioni për Promovim, Edukim Joformal dhe Punësim | 4 | 5 |
| | Divizioni për Zhvillim të Politikave Rinore | 6 | 6 |
| | Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror | 6 | 5 |
| **Departamenti I Kulturës** | 🔴 Divizioni i Arteve Skenike, Muzikore dhe Pamore Komunale | 9 | 2 |
| | Divizioni i Promovimit Kulturor | 7 | 8 |
| | Divizioni për Librin dhe Bibliotekat | 4 | 3 |
| **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave** | Divizioni për Integrime Evropiane | 3 | 3 |
| | Divizioni për Koordinim të Politikave | 2 | 2 |
| **Departamenti i Sportit** | Divizioni për Komitetin Olimpik të Kosovës, Komitetin Paraolimpik të Kosovës dhe Federatat Sportive | 9 | 8 |
| | Divizioni për Infrastrukturë Sportive | 7 | 5 |
| | Divizioni i Sportit për të Gjithë dhe Sportit Shkollor | 5 | 5 |
| **Departamenti i Trashëgimisë Kulturore** | Divizioni për Trashëgimi Arkeologjike dhe Arkitekturore | 4 | 1 |
| | Divizioni për Trashëgiminë e Luajtshme dhe Shpirtërore | 5 | |
| | 🔴 Divizioni për Menaxhim të Integruar dhe Turizëm Kulturor | 4 | 1 |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | Divizioni i Burimeve Njerëzore | 13 | 11 |
| | Divizioni për Buxhet e Financa | 12 | 11 |
| | 🔴 Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike | 19 | 20 |
| 🟡 **Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta** | | | 2 |
| | | Totali 146 | 147 |

🔴 Ushtrues i detyrës

🟡 Pozita të pa plotësuara

# MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL

## Historiku

Ministria e Zhvillimit Rajonal është përgjegjëse për përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e zhvillimit rajonal dhe zbatimin e tyre;

në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për punë të jashtme dhe diasporë dhe me ministritë e përkatëse, zhvillon dhe merr pjesë në nismat dhe programet rajonale sa i përket fushës së zhvillimit rajonal; planifikon dhe zhvillon treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar; koordinon aktivitetet me institucione të nivelit qendror dhe lokal si dhe akterë tjerë relevant në përkrahje të zhvillimit socioekonomik rajonal të balancuar dhe regjenerimit të vendeve të reja të punës; në bashkëpunim me institucionin përgjegjës për integrim evropian dhe ministrinë përkatëse për financa, dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi merr pjesë në administrimin e ndihmës së huaj financiare në fushën e zhvillimit rajonal; zhvillon dhe menaxhon programe për të ofruar zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe bën promovimin e tyre; bashkërendohet me ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri dhe institucionet e tjera për zhvillimin e zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socioekonomik rajonal të balancuar, etj.

## Organizimi

Ministria e Zhvillimit Rajonal ka gjithsejt 5 departamente dhe 15 divizione me aktualisht 50 të punësuar.

## Ushtruesit e Detyrës

Të gjitha departamentet udhëhiqen nga persona të emëruar në pozita të rregullta[62]. Momentalisht Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm udhëhiqet me ushtrues detyre.

## Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Zhvillimit Rajonal ka mbetur e paprekur nga procesi i ristrukturimit mrëpo e njëjta ka miratuar rregulloren e re për organizimin e kësaj ministrie në shkurt të vitit 2024.[63]

Tabela [...]

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|

62 Pozitë e rregulltë nënkupton kur në pozita ushtrohet nga nëpunsi civil I cili është emruar dhe ka një akt emërim të ligjshëm për ushtrimin e asaj pozite.

63 Rregullore (Zkm) Nr. 02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë për Zhvillm Rajonal, e qasshme në: https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/51C8F5DC-4AA5-4AFB-8AB3-667CA877BE25.pdf

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kabineti I Ministrit** | | 18 | 18 |
| 🔴 **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm | 4 | 2 |
| | Njësia e Auditimit të Brendshëm | 3 | 1 |
| | Divizioni i Prokurimit | 3 | 2 |
| | Divizioni Ligjor | 3 | 2 |
| | Divizioni për Komunikim Publik | 3 | 1 |
| | Divizioni për Buxhet dhe Financa | 4 | 4 |
| | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | 3 | 2 |
| | | | |
| 🔴 **Departamenti për Planifikim dhe Koordinim te Zhvillimit Rajonal** | Divizioni për Koordinim të Zhvillimit Rajonal - 🔴 | 3 | 2 |
| | Divizioni për Koordinim të Nismave Rajonale | 3 | 2 |
| | Divizioni për Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve të Zhvillimit Rajonal | 3 | 3 |
| **Departamenti për Përformancë dhe Analiza Rajonale** | Divizioni për Përformancë të Zhvillimit Rajonal të Balancuar | 3 | 2 |
| | Divizioni për Analiza Socio-Ekonomike Rajonale | 3 | 2 |
| **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave** | Divizioni për Integrime Evropiane | 3 | 2 |
| | Divizioni për Koordinim të Politikave | 3 | 1 |
| **Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme** | | | |
| | Divizioni për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkivim- 🔴 | 3 | 1 |
| | Divizionit për Teknologji Informative dhe Logjistikë | 3 | 3 |

# MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

## Historiku i MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2004. Funksionin e saj, MAPL e ushtron në bazë të Kushtetutës, Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Përgjatë këtyre viteve, MAPL ka qenë direkt e përfshirë në procesin e reformës së pushtetit lokal, respektivisht shtrirjen e procesit të decentralizimit në vend, sigurimit të kompetencave të mjaftueshme të pushtetit lokal dhe ushtrimit të tyre në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm. MAPL ndjek një politikë të afirmimit të të drejtave të komunave

në rregullimin e çështjeve publike, krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme të komunave për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit dhe parimeve të tjera të qeverisjes së mirë.

## Organizimi

Struktura organizative është si vijon: Ministri, Zëvendësministrat, Sekretari i Përgjithshëm, Departamentet dhe Divizionet.

Departamentet janë të organizuara në divizione të cilat ushtrojnë kompetenca në fusha të ndërlidhura.

Numri i të punësuarve në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) gjithsej është njëqind e pesëdhjetë e katër (154), ku prej tyre njëqind e tridhjetë e shtatë (137) punonjës janë në stafin civil dhe shtatëmbëdhjetë (17) punonjës në stafin politik.

## Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka mbetur e paprekur nga procesi i ristrukturimit.

Tabela [...]

| Niveli Organizativ/Departamenti | Niveli organizativ/ Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|
| **Kabineti I Ministrit** | | | 15 |
| 🔴 **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | 🔴 Divizioni i Auditimit të Brendshëm | 4 | 3 |
| | 🔴 Divizioni i Prokurimit | 4 | 3 |
| | Divizioni për Komunikim Publik | 5 | 3 |
| **Departamenti për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal:** | Divizioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal | 5 | 3 |
| | 🔴 Divizioni për Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve në Komuna | 6 | 3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitarë** | Divizioni për Bashkëpunim NdërKomunal | 5 | 3 |
| | Divizioni për Bashkëpunim Ndërkufitar | 7 | 3 |
| | Divizioni për Kontroll të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar | 4 | 2 |
| **Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale** | Divizioni për Matje të Performancës Komunale | 5 | 6 |
| | Divizioni për Avancim të Kapaciteteve dhe Reformave Komunale | 4 | 3 |
| | Divizioni për Transparencë Komunale | 4 | 3 |
| **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave** | Divizioni për Integrime Evropiane | 4 | 4 |
| | Divizioni për Koordinim të Politikave | 4 | 3 |
| **Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave** | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 4 | 3 |
| | Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | 3 | 3 |
| | Divizioni për Monitorim të Komunave | 14 | 7 |
| | Divizioni për Avancim të të Drejtave të Njeriut | 4 | 2 |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | Divizioni për Buxhet dhe Financa | 9 | 4 |
| | Divizioni i Burimeve Njerëzore | 4 | 3 |
| | Divizioni për Shërbime Logjistike dhe Mbështetje të IT-së | 12 | 9 |
| | Divizioni për Arkivë, Dokumentim dhe Përkthim | 11 | 10 |
| Ushtrues i detyrës | Totali | 122 | 98 |

# Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

## Historiku

Kjo ministri fillimisht ishte krijuar si departament dhe quhej Departamenti Administrativ i Arsimit dhe Shkencës në kohën e UNMIK-ut në vitin 2000. Respektivisht, Departamenti për Arsim u krijua në bazë të Rregullores nr.2000/11[64] për themelimin e Departamentit Administrativ të Arsimit dhe Shkencës. Si i tillë Departamenti vazhdoi së ekzistuari deri në vitin 2001, kur me Rregulloren e UNMIK-ut RREG/2001/19 u shndërrua në ministri, së bashku me një numër të madh të ministrive tjera. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka vepruar si një ministri e vetme deri në vitin 2020 kur me Rregulloren Nr.06/2021[65] për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, i shtohet fushëveprimtaria e inovacionit shkencor. Po, ashtu me Rregullorën e vitit Nr. 02/2021 fusha e inovacionit shkencor është pjesë e shtuar e fushëveprimtarisë dhe me këtë rregullore edhe emri i ministrisë pëson ndryshime dhe bëhet Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), nga MASHT. Ndërsa, Ministria e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit është themeluar në vitin 2018, dhe në vitin 2020 dhe 2021 është ristrukturuar apo bashkuar në dy ministri tjera pjesa e ndërmarrësisë ka kaluar tek Ministria, e Industrise, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kurse pjesa e Inovacionit tek ajo e Arsimit.

## Organizimi

Organizimi i brendshëm i Ministrisë se Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është bërë sipas Rregullores Nr.14/2018[66] dhe e njëjta vlen edhe tash. MASHTI aktualisht ka 5 departamente dhe 26 divizione. Në anën tjetër rregullimi i punës së Ministrisë së Ndërmarrësisë dhe Inovacionit është bërë me anë të Rregullorës nr.23/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë[67] në bazë të së cilës kjo ministri ka 1 departament të Inovacionit dhe 2 divizione.

## Pozitat Udhëheqëse

Aktualisht nga 5 departamente, **3 pozita** të udhëheqësve të departamenteve janë ushtrues detyre kurse **2 janë në pozita të rregullta**. Kurse, nga **26 divizione**, 16 janë me pozita të rregullta kurse **10 divizione** udhëhiqen me **ushtrues detyre – UD.**

## Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit aktualisht nuk ka rregullore të re e cila definon organizimin e brendshëm pas ristrukturimit apo bashkimit te Inovacionit me MASHT. Rrjedhimisht, nuk ka të dhëna të sakta për pozitat që derivojnë në fushën e Inovacionit e po ashtu edhe fushëveprimtarinë e

64 Rregullore Nr.2000/11. UNMIM, 3 Mars 2000 e qasshme ne: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_11.htm

65 Rregullore(QRK)-Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317

66 Rregullore(QRK)-Nr.14/2018 për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e qassshme në:https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17922

67 Rregullore (QRK) Nr.23/2017 për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e qasshme në:https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15938

saktë. Për këtë Ministri, me 13 shtator 2024, është miratuar rregullorja e re.[68]

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|
| **Kabineti I Ministrit** | | | 19 |
| **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | Divizioni për njohje/barasvlere dhe informim akademik | 6 | 5 |
| | Divizioni i auditimit të brendshëm | 3 | 2 |
| | Divizioni për komunikim me publikun | 4 | 2 |
| | Divizioni i Prokurimit Publik | 4 | 4 |
| **🔴 Departamenti për Arsim para universitar** | Divizioni i arsimit të hershëm dhe parashkollor | 3 | 3 |
| | Divizioni për arsim të përgjithshëm | 7 | 7 |
| | Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve | 20 | 16 |
| | 🔴 Divizioni për sigurimin e cilësisë, standarde, vlerësim dhe licencim | 10 | 8 |
| | Divizioni per planifikim dhe standarde te infrastrukturës shkollore | 4 | 2 |
| | 🔴 Divizioni i arsimit gjithëpërfshirës | 9 | 11 |
| **Departamenti i Arsimit dhe aftësimit profesional** | 🔴 Divizioni për infrastrukturën e shkollave, programet e AAP-së dhe për analiza të tregut të punës | 4 | 1 |
| | Divizioni për standardet e AAP-së dhe sigurim të cilësisë | 3 | 6 |
| | 🔴 Divizioni për mësim tërjetësor | 3 | 1 |
| **🔴 Departamenti i Arsimit të lartë, shkencës dhe teknologjisë.** | Divizioni për menaxhim, standarde dhe sigurim të cilësisë në arsimin e lartë; | 4 | 3 |
| | Divizioni i shkencës dhe teknologjisë; | 3 | 4 |
| | 🔴 Divizioni për inovacion dhe transfer të teknologjisë | 3 | 1 |
| | Divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar në shkencë dhe arsim të lartë; | 3 | 2 |
| | 🔴 Divizioni per ekzaminimin e profesioneve te rregulluara | 3 | 1 |

68 https://masht.rks-gov.net/rregullore-zkm-nr-09-2024per-organizimin-e-brendshem-dhe-sistematizimin-even-deve-te-punes-ne-ministrine-e-arsimit-shkencesteknologjise-dhe-inovacionit1/

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti për integrime evropiane, koordinim të politikave dhe çështjeve ligjore** | ● Divizioni për integrim evropian | 3 | 4 |
| | Divizioni për koordinim të politikave dhe monitorim të projekteve | 3 | 11 |
| | Divizioni për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit | 8 | 4 |
| | Divizioni për zbatimin e projektit | 4 | 5 |
| | ● Divizioni për grumbullimin dhe analizën e të dhënave | 5 | 1 |
| **● Departamenti i financave dhe shërbimeve të përgjithshme** | Divizioni i buxhetit dhe financave | 9 | 12 |
| | ● Divizioni i burimeve njerëzore | 13 | 10 |
| | ● Divizioni i teknologjisë informative (TI) dhe shërbimeve logjistike | 32 | 18 |
| ● Ushtrues i detyrës | Totali | 173 | 163 |

# Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukrurës (MMPHI)

## Historiku

Ministria mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës (MMPHI) funksionon si e tillë që nga marsi i vitit 2021, pas bashkimit të Ministrisë së mjedisit, planifikimit hapësinor me Ministrinë e Infrastrukturës. Ky bashkim ka ndodhur me anë të vendimit Nr.08-V-005 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më pas e pasqyruar edhe në Rregulloren (QKK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive.[69]

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Mandati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor fillimisht është përcaktuar me rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/5[70]. Pastaj kjo rregullore u ndryshua dhe fushëveprimtaria e organizimi i brendshëm i kësaj ministrie u bazua në Rregulloren (QRK) Nr.05/2017[71] për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit

Mandati dhe fushëveprimtaria e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit fillimisht është rregulluar në bazë të rregullorës së UNMIK/RREG/2001/19[72] dhe në atë kohë është quajtur Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, kurse me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2002/5, kjo ministri definohet si Ministria e Transportit dhe Komunikacionit. Tutje, kjo ministri shndërrohet në Ministria e Infrastrukturës

69 Rregullore(QRK)-Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317

70 Rregullore Nr.2002/5 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi ekzekutivin e institucioneve të përkohshme të vetqeverisjes, e qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2002regs/RA2002_05.pdf

71 Rregullore(QRK)-Nr.05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14800

72 Rregullore Nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë:https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_19.pdf?fbclid=IëAR2DgFAmfalY82P-fvTQdëknu4ZChLOE26NAkGjZZq6nCmzObuëËËVf8ëëEo

dhe Transportit (MIT) dhe fushëveprimataria dhe organizimi i brendshëm bazohet në bazë të Rregullorës (QRK) Nr.16/2015[73] për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Infrastrukturës.

## Organizimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor nuk ka rregullore të re që e definon sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të ministrisë pas bashkimit me Ministrinë e Infrastrukturës. Fushëveprimtaria, sistematizimi i vendeve të punës dhe organizimi i brendshëm i kësaj ministrie bazohet në Rregulloren (QRK)-Nr.05/2017.[74] Bazuar në këtë rregullore, ministria e mjedist pa inkorporimin e pjesës së infarstrukturës ka **7 departamente**, po ashtu Institutin për Planifikim Hapësinor si dhe Autoritetin Rajonal të Pellgjeve ujorë. Kurse numëron **27 divizone.** Ndërsa, organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në Ministrinë e Infraskturës është bërë në bazë të Rregullores(QRK) Nr-16/2015.[75] Deri para ristrukturimit kjo ministri ka numëruar **11 departamente dhe 22 divizione**.

## Pozitat udhëheqëse

Nga **7 departamente** në Ministrinë e Mjedisit, **6 janë me pozita të rregullta** kurse 1 është me **ushtrues detyre- UD**. Sekretari i Përgjithshëm është me ushtrues detyre-UD. Përderisa Instituti për Planifikim Hapësinor udhëhiqet me pozitë të rregullt, kurse Autoriteti Rajonal për Pellgje Ujore udhëheqet nga një **ushtrues detyre- UD**. Ndërsa, nga 28 divizione, 22 janë nën udhëheqje me pozitë të rregullt, për një divizion nuk ka informacione, kurse **5 divizione udhëheqen nga ushtrues detyre-UD**. Në anën tjetër, nga hulumtimi jonë në Ministrinë e Infrastrukturës, nga 11 departamente, **8 janë me pozitë të rregullt**, për një departement nuk ka informacione, kurse 2 janë me ushtrues detyre-UD. Gjithashtu pozita e Sekretarit të Përgjithshëm është me ushtrues detyre-UD. Kurse nga **28 divizione, 19 janë me pozita të rregullta**, njësia për burime njerëzore është me pozitë të rregullt, për dy divizione nuk ka informacion, kurse 7 janë me ushtrues detyre- UD.

## Gjendja pas ristrukturimit

Nga prilli i vitit 2024, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka rregullore të re[76] e cila definon organizimin e brendshëm pas ristrukturimit apo bashkimit të ministrisë së mjedisit me atë të infrastrukturës. Mirëpo këto ministri ende funksionojnë si të ndara duke qenë se procesi nga komisioni i ristrukturimit nuk ka përfunduar.

Ministria e Ambientit

| Niveli Organizativ/ Departamenti | Niveli organizativ/Divizioni | Nëpunësit sipas rregulloreve | Nëpunësit aktual |
|---|---|---|---|

73 Rregullore (QRK) Nr.16/2015 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Infrastrukturës, e qasshme në:https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11287

74 Rregullore (QRK) Nr.05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14800

75 Rregullore (QRK) Nr. 16/2015 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Infrastrukturës, e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11287

76 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=88358

| | | | |
|---|---|---|---|
| 🔴 **Zyra e Sekretarit te Përgjithshëm** | Divizioni i Auditimit te brendshëm | 3 | 3 |
| | Divizioni i Komunikimit me Publikun | 4 | 4 |
| | Divizioni i Prokurimit | | 4 |
| 🔴 **Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave** | Divizioni për Ujera | 6 | 6 |
| | 🔴 Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale | 9 | 8 |
| | 🔴 Divizioni për Kimikate dhe Mbeturina | 6 | 5 |
| | Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. | 5 | 4 |
| **Instituti për Planifikim Hapësinor;** | Divizioni për Planifikim dhe Bashkëpunim | 4 | 4 |
| | Divizioni për Hulumtim dhe Vlerësim | 4 | 4 |
| | Divizioni i GIS-it për Planifikim Hapësinor | 4 | 4 |
| **Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit:** | Divizioni i Planifikimit Hapësinor | 6 | 7 |
| | Divizioni për Ndërtim | 4 | 4 |
| | Divizioni për Banim | 5 | 5 |
| 🔴 **Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore;** | Divizioni për Menaxhimin e resurseve ujore | 5 | 4 |
| | 🔴 Divizioni për Planifikimin e Resurseve Ujore | 4 | 3 |
| | Divizioni për Pagesat Ujore dhe Projekte | 4 | 4 |
| **Departamenti për inspektim të mjedisit, natyrës, ujërave, ndërtimit dhe planifikimit hapësinor:** | 🔴 Divizioni për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave | 20 | 17 |
| | Divizioni për Inspektim të Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtim | 9 | 8 |
| **Departamenti për Shpronësim:** | 🟡 Divizioni për Çështje Pronësore | 3 | |
| | Divizioni Tekniko-Financiar | 3 | 3 |
| **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave:** | Divizioni i Integrimit Evropian | 3 | 3 |
| | Divizioni për Koordinim të Politikave | 3 | 1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti Ligjor** | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 4 | 3 |
| | Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | 5 | 4 |
| | 🟡 Divizioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave (organi i shkallës së dytë në Procedurën Administrative) | 4 | |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | Divizioni për Burime Njerëzore | 7 | 5 |
| | Divizioni për Buxhet dhe Financa | 16 | 8 |
| | Divizioni për TI dhe Shërbime Logjistike | 30 | 28 |
| 🔴 Ushtrues i detyrës | Totali | 180 | 153 |

🟡 Pozita të pa plotësuara

Ministria e Infrastrukturës

| **Niveli Organizativ/ Departamenti** | **Niveli organizativ/Divizioni** | **Nëpunësit sipas rregulloreve** | **Nëpunësit aktual** |
|---|---|---|---|
| 🔴 **Zyra e Sekretarit te Përgjithshëm** | Divizioni i Auditimit të brendshëm<br>🔴 Divizioni i Komunikimit me Publikun<br>Divizioni i Prokurimit | 13 | 10 |
| 🔴 **Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve** | 🔴 Divizioni për mirëmbajtje të rrugëve;<br>Divizioni për ndërtim dhe rekonstruktim te rrugëve;<br>Divizioni i mbështetjes teknike, pronave, sigurisë rrugore dhe peshoreve. | 49 | 51 |
| **Departamenti i Infrastrukturës Rrugore** | Divizioni i Zhvillimit të Rrjetit Rrugor;<br>🔴 Divizioni i Projekteve. | 10 | 9 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti i Inspektimit** | Divizioni i Inspektimit për transport rrugor; | 20 | 24 |
| | Divizioni i Inspektimit për Kontroll Teknike; | | |
| | Divizioni i Inspektimit për Auto Shkolla. | | |
| | ● Divizioni i Inspektimit për infrastrukture rrugore. | | |
| **Departamenti i Transportit Tokesor** | ● Divizioni i Transportit te Mallrave; | 9 | 16 |
| | ● Divizioni i Transportit te Udhëtarëve; | | |
| | Divizioni për Zhvillimin e Politikave dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Transportin Tokësor | | |
| **Departamenti i Aviacioni Civil** | Divizioni i Licencimeve dhe Rregullimit Ekonomik | 4 | 4 |
| | Divizioni i Politikave Zhvillimore | | |
| **Departamenti i Automjeteve** | Divizioni i Çështjeve Teknik | 18 | 21 |
| | Divizioni i Auto Shkollave | | |
| **Departamenti i patent shoferit** | Divizioni për Patent Shofer | 69 | 69 |
| | Divizioni për Pyetës | | |
| **Departamenti Koordinues i Këshillit për Siguri në Komunikacion Rrugor** | Nuk ka divizione ky departament | | 3 |
| **Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave** | Divizioni i Integrimeve Evropiane | 3 | 5 |
| | Divizioni për Koordinim të Politikave | | |
| **Departamenti Ligjo** | ● Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 4 | 4 |
| | Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | | |
| **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme** | Njësia për Burime Njerëzore | 24 | 33 |
| | Divizioni për Buxhet dhe Financa | | |
| | Divizioni për zhvillimin dhe përgatitjen e testeve për patën shofer | | |
| | Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike | | |

Ushtrues i detyrës — Totali 223 249

# Ministria e Ekonomisë

## Historiku

Ministria e Ekonomisë fillimisht është quajtuar Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe fushëveprimtaria, rregullimi dhe sistematizimi i vendeve të punës është bërë në bazë të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2002/5.[77] Megjithatë, kjo Ministri ka qenë e fuzionua/bashkuar r edhe me ministria tjera dhe fushëveprimtaria ka qene me e gjerë. Një bashkim ka ndodhur me anë të vendimit Nr.07-V-005 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku Ministria e Ekonomisë dhe Financave shndërrohet në Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS). Kjo ministri më pastaj me anë të vendimit Nr.08-V-005 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më pas e pasqyruar edhe në Rregulloren (QKK) nr. 02/2021[78] për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive shndërrohet në Ministria e Ekonomisë (ME).

## Organizimi

Sistematizimi dhe organizimi i vendeve të punës së Ministrisë së Ekonomisë është bërë në bazë të Rregullores Nr.03/2012[79] për organizmin e brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në atë kohë. Aktualisht nuk ka rregullore të re përpos asaj të vitit 2012 për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të kësaj ministrie. Aktualisht, kjo ministri i ka **6 departamente, 2 agjenci, 21 divizione, 3 drejtorate, 3 sektore, 1 njësi, 1 inspektorat, dhe 1 muze**.

## Pozitat Udhëheqëse

Nga 6 departamente, **4** udhëhiqen me **pozita të rregullta**, kurse **2** janë me **ushtrues detyre-UD**. Po ashtu zyra e sekretarit të përgjithshëm është me ushtrues detyre-UD. Nga 21 divizione, **14 janë nën udhëheqje me pozitë të rregullt**, për një divizion nuk ka informacion, dhe **6 divizione** janë me udhëheqje me ushtrues detyre-UD. Nga **3 sektore**, **2 udhëhiqen me pozitë të rregullt**, kurse për 1 sektor nuk ka informacion, kurse nga 3 drejtorate, **2 janë me pozitë të rregullt** dhe për një drejtorat nuk ka informacion. Një njësi është me ushtrues detyre-UD, dhe për pozitën e Muzeut shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve – Trepça nuk ka informacione.

## Gjendja pas ristrukturimit

Ministria e Ekonomisë ka miratuar rregulloren e re në mars të vitit 2023.[80] Kjo Ministri nuk ka dërguar të dhëna të përditësuara dhe nuk ka informacione nëse për të njëjtën është krijuar komisioni i ristrukturimit.

77 Rregullore Nr.2002/5 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi ekzekutivin e institucioneve të përkohshme të vetqeverisjes, e qasshme në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2002regs/RA2002_05.pdf

78 Rregullore (QRK)- Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, e qasshme në:https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317

79 Rregullore NR.03/2012 për organizmin e brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e qasshme në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8354

80 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71785

| Niveli/Departamenti Organizativ | Niveli/Divizioni Organizativ | Stafi aktual |
|---|---|---|
| 🔴 **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** | Njësia e Inspektimit të Energjisë | 2 |
| | Divizioni për Komunikim Publik | 3 |
| | Njësia e Burimeve Njerëzore | 3 |
| | Divizioni i Prokurimit | 1 |
| **Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike** | | 27 |
| **Njësia e Auditimit të Brendshëm** | | 2 |
| 🟡 **Njësia për Zbatimin e Projekteve nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë** | 🔴 Divizioni për Mbështetjen Administrative të Projekteve të Energjisë së Rinovueshme | 1 |
| | Divizioni për Mbështetjen Teknike të Projekteve të Energjisë së Rinovueshme | |
| 🔴 **Departamenti i Energjisë** | 🔴 Divizioni i Planifikimit Strategjik dhe Bashkëpunimit Rajonal | 18 |
| | Divizioni i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë | |
| | Divizioni i Efiçiencës së Energjisë | |
| | 🔴 Divizioni i Sistemeve Energjetike | |
| **Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit** | Divizioni i Teknologjisë së Informacionit | 4 |
| | 🟡 Divizioni i Komunikimeve Elektronike dhe Postare | |
| | Divizioni i Ekonomisë Dixhitale | |
| **Departamenti Ligjor** | Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit | 5 |
| | Divizioni për Monitorimin e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjen Ligjore dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | |
| **Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave**<br><br>**Departamenti për Buxhet dhe Financa** | 🔴 Divizioni për Integrime Evropiane | 9 |
| | Divizioni për Koordinimin e Politikave | |
| **Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme**<br><br>**Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave** | Divizioni për Buxhet dhe Planifikim | 9 |
| | 🔴 Divizioni për Financa dhe Kontabilitet | |

| | | |
|---|---|---|
| Departamenti për Buxhet dhe Financa | 🟡 Divizioni i Teknologjisë së Informacionit dhe Administrimit të Dokumenteve dhe Shërbimeve | 0 |
| | Divizioni për Transport dhe Logjistikë | |
| | Departamenti i Gjeologjisë Rajonale | |
| | Departamenti i Sedimentologjisë | |
| | Departamenti i Sizmologjisë | 21 |
| 🔴 Shërbimi Gjeologjik I Kosovës | Departamenti i Gjeoinformacionit | |
| | Departamenti i Laboratorit të Gjeologjisë | |
| | Departamenti i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve - Trepça | |

🔴 Ushtrues detyre — Gjithsej 149

🟡 Pozitat e paplotësuara